



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Kom.Dh.Shk.II.nr.1281/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen përmbaremore të kreditorit sh.p.k, me NUI: me adresë – Skenderaj, me përfaqësues M.H., ndaj debitorit KUR “Mitrovica” sh.a me NUI:, me nr. biznesit, me adresë në Mitrovicë, për shkak të borxhit, në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.271/2020 të dt. 19.01.2021, jashtë seancës më datën 24.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit KUR Mitrovica në Mitrovicë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.271/2020 të dt.19.01.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.271/2020 të dt. 19.01.2021, ka vendosur si në vijim: Refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit: Kompania Rajonale e Ujësjetësimit sh.a Mitrovicë, ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbaremit P.nr.252/20 dt. 05.06.2020, sipas propozimit të kreditorit sh.p.k me nui, me adresë – Skenderaj, me përfaqësues M.H..

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit dhe të anulohet aktvendimi i atakuar.

Ankesa i është dërguar në mënyrë të rregullt të autorizuarit së kreditorit, por e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale–Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori sh.p.k, me NUI: me adresë – Skenderaj, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit KUR Mitrovica sh.a me NUI:, me nr. biznesit, me adresë në Mitrovicë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës me nr..... dt. 23.12.2019, për shumën e detyrimit në vlerë prej 4,973.08€, me kamatë ligjore prej 8%, me gjithë shpenzimet e përmbarimit dhe tarifën e efikasitetit për vlerën e përmbaruar (më gjerësisht sikur në propozimin për përmbarim)

Përmbaruesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi me seli në Prishtinë, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.252/20 të dt.05.06.2020, ka caktuar përmbarimin, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm–fatura e lartcekur, i plotëson kushtet për përmbarim.

Ndaj këtij urdhri me dt. 08.07.2020, ka paraqitur prapësim debitori, me të cilin ka propozuar që gjykata të bien vendim që propozimin për përmbarim të hedhet poshtë si të pa lejuar, për arsyet e cekura në prapësim ose të caktohet eksperti i lëmisë përkatëse në mënyrë që të verifikohen thëniet në prapësim dhe të thirren palët në seancë në mënyrë që të sqarohen rrethanat. Përgjigje në prapësim ka paraqitur i autorizuari i kreditorit, me dt.13.07.2020, duke theksuar që kundërshtimet e debitorit në prapësim janë të pa sakta dhe jo reale, andaj i ka propozuar gjykatës që të vazhdohet me ekzekutimin e urdhrit përmbarimor.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.271/2020 të dt. 19.01.2021, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur me decidivisht sikur në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe lidhur me pretendimin e debitorit kur thirret në atë se punëkryesi në këtë rast kreditori nuk ju ka përmbaruar kontratës duke mos i përfunduar punimet konform projektit dhe konform kontratës dhe gjithashtu punët shtesë kanë qenë të parapara të bëhet pagesa pasi të përfundojnë të gjitha punët konform kontratës, gjykata i refuzoj si të pa bazuara, pasi që fillimisht kreditori iu ka drejtuar debitorit me kërkesën e dt. 20.12.2019 lidhur me pagesën për punët shtesë të kryera në shumë prej 4.973.08, e po ashtu nga shkresa me titull Paramasa dhe Paralogaria e Punëve ndërtimore, e pranuar dhe e dorzuar ndërmjet palëve ndërgjyqëse është paraparë që për punët ndërtimore të bëra nga ana e kreditorit të bëra nga ana e kreditorit të paguhet shuma prej 4.973.09, nga shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se debitori të jetë përgjigjur kreditorit lidhur me kërkesën e lartpërmendur. Gjykata vazhdon tutje duke arsyetuar vendosjen sikur në dispozitiv dhe atë duke u mbështetur në faturën me nr. dt. 23.12.2019, faturë kjo e pranuar nga pala debitorë ku shihet qartë se kreditori me debitorin kanë pranuar obligimet që rrjedhin nga kontrata KRUM të dt. 06.06.2019, 05/1-336, dhe atë për pjesën e punëve shtesë të përfunduara nga ana e kreditorit, shuma e arritur për pagesën nga ana e debitorit ka arrit në vlerën prej 4.973.08, po ashtu faktin se debitori ka

obligim ndaj kreditorit si në të lartcekurat gjykata e bazoj edhe në deklaratën e debitorit në këtë rast Menaxherit I.H. i cili ka deklaruar se kanë filluar punimet për ndërtimin e objektit KRUM të ujësjellësit në rr. “.....” në lagjen 3. Me tutje ka deklaruar se në dinamikën e zhvillimit të punimeve deri në këtë datë janë kryer punët shtesë sipas paramasës dhe paralogarisë në situacionin e krijuar për punët shtesë që janë të përshkruar në paramasë. Vendimin gjykata e bazoj në nenin 245 par 1 dhe 249 par 1 të LMD –së dhe pretendimet e debitorit në prapësim nuk mund ti aprovoj si të bazuara për faktin se të njëjtat ishin në kundërshtim me provat e prezantuara në vet shkresat e lëndës dhe nuk ishin të mbështetura në nenin 69 dhe 71 të LPP –së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbartimore, përkatësisht neni 29 par 1. nën par.1.3 dhe par 3 i cili përcakton se: “ *Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: fatura. Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar* ”. Gjithashtu neni 37 dhe 40 par.1 pika 3 i LPP-së, përcakton se propozimi për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë “*originalin apo kopjen e vërtetuar e dokumentit të besueshëm*”, e në rastin konkret fatura po ashtu edhe propozimi i përmbart të gjitha elementet e kërkuara nga dispozitat e lartpërmendura, andaj si i tillë dokumenti i besueshëm përmbart tiparet e nevojshme të përmbartueshmërisë të përcaktuar sipas dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbartimore. Debitori në prapësim nuk ka ofruar ndonjë argument apo provë me të cilën kishte me paraqitur ndonjë nga shkaqet që janë të parapara me nenin 71 të LPP-së.

Duke u mbështetur në nenin 69 par.4 të LPP “*baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet*”, me çka debitori nuk ka ofruar ndonjë provë për të vërtetuar të kundërtën e kreditorit, por edhe pretendimet e vetë debitorit në prapësim.

Pretendimet ankimore të debitorit lidhur me aplikimin e gabuar të dispozitave materiale sa i përket kamatës së gjykuar, kjo gjykatë i refuzoj si të pa bazuara dhe atë duke u mbështetur në dispozitivin e nenin 382 të LMD –së, cila përcakton se: “ *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e*

kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”, andaj si i drejtë dhe në harmoni të plotë me dispozitat ligjore del të jetë vendimi i gjykatës së shkallës së parë edhe në këtë pjesë.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarrimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi në rastin e kryerjes se përmbarrimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarrimit në këtë rast.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet tjera ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka lejuar urdhrin për caktimin e përmbarrimit të Përmbarruesit Privat, P.nr.252/20 dt. 05.06.2020.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1281/22 dt. 24.08.2022

Gjyqtari,
Krenar Berisha